



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**Ac.nr.969/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, me gjyqtaren individuale Halide Reka, në çështjen juridike përbarimore të kreditores Gjykata Themelore Prizren, ndaj debitores Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, me bazë juridike përbarimore pagesën e gjobës, duke vendosur lidhur me ankesën e debitores, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Cp.nr.1613/20 të datës 28.01.2021, jashtë seance me dt.02.11.2023, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**APROVOHET** si e bazuar ankesa e debitores Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, **ANULOHET** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Cp.nr.1613/20 të datës 28.01.2021 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prizren, me aktvendimin e atakuar CP.nr. 1613/2020 të datës 28.01.2021 e ka hedhë poshtë si të pa themeltë kundërshtimin e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit mbi lejimin e ekzekutimit të kësaj gjykate CP.nr. 1613/2020 të datës 05.02.2021.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, debitorja Komuna e Prizrenit ka paraqitur ankesë duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesa të aprovohet si e bazuar, të anulohet aktvendimi i atakuar dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë.

Kreditorja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e debitorit.

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtares individuale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën

Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore (LPP) dhe gjeti se:

*Ankesa e debitorës është e bazuar.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditorja me datën 03.11.2020, ka ushtruar propozim për lejimin e përbarimit ndaj debitorës Komuna e Prizrenit, për shkak të mos respektimit të Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren CP. Nr. 2457/2019 të dt. 10.12.2019 .

Gjykata Themelore në Prizren duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorës me Aktvendimin CP.nr.1613/2020 të datës 05.01.2021, e ka lejuar përbarimin duke vlerësuar se dokumenti përbarimor i plotëson kushtet për përbarim.

Kundër aktvendimit mbi lejimin e përbarimit debitorja ka paraqitur prapësim me dt. 19.01.2021 me të cilin e ka kundërshtuar aktvendimin e sipërcituar me propozim për gjykatën që prapësimi të aprovohet si i bazuar ndërsa aktvendimi për lejimin e përbarimit të anulohet.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimi të debitorës me aktvendimin e ankimuar Cp.nr.1613/20 të datës 28.01.2021, e ka hedhë poshtë si të pa themelë kundërshtimin e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit mbi lejimin e ekzekutimit të kësaj gjykate CP.nr. 1613/2020 të datës 05.02.2021.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se kundërshtimi i debitorit është i pa themelë për faktin se nuk ekziston asnjë nga shkaqet të cilat janë të parapara në nenin 55 të LPP-së, e që do ta pengonin përbarimin e lejuar.

Duke i pasur për bazë pretendimet ankimore të debitorës, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se konstatimi dhe vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë tani për tani nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në rastin konkret kur ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar ka dështuar të vërtetoj faktet vendimtare nëse kemi të bëjmë në këtë rast me refuzim si të pathemeltë të kundërshtimit të debitorit apo nëse kundërshtimi i debitorit është hedhë poshtë si i palejuar.

Dispozitivi i aktvendimit është i paqartë dhe konfuz madje mënyra e vendosjes dhe arsyeja për vendosje si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk mund të kuptohet as nga arsyetimi i aktvendimit ngase vendimi i ankimuar nuk përmban fare arsye për vendosje.

Në arsyetimin e aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë si arsye të vetme për pa themelësinë e kundërshtimit i është referuar mungesës së shkaqeve të parapara me dispozitën e nenit 55 të LPP-së ( i cili nuk ka qenë në fuqi në kohën e ushtrimit të propozimit për përbarim), duke vlerësuar si shkaqe të cilat do të pengonin përbarimin e lejuar, mirëpo gjykata e shkallës së parë vetëm ka përmendur dispozitën e LPP-së por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura

nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me këtë dispozitë jep përfundimin mbi pathemelësinë e prapësimit.

Të gjeturat e konstatuara si më lartë nga gjykata e shkallës së dytë aktvendimin e ankimuar e bëjnë jo të drejtë dhe pa mbështetje në ligj, ku si i tillë i njëjti u dashtë që të anulohet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, e cila në riprocedurë udhëzohet që duke pasur parasysh të gjeturat e konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, me rastin e vendosjes lidhur me prapësimin e debitorës të marr vendim të drejt dhe të ligjshëm sipas kërkesave të LPK-së, nga neni 160 paragrafi 3 dhe 4 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, në atë mënyrë që dispozitivi i vendimit duhet të jetë i kuptueshëm dhe i përmbarueshëm dhe në arsyetimin e aktvendimit të paraqes arsye të qarta për të gjitha faktet vendimtare përkitazi me vendosjen.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 pika (d) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.969/2021, me datën 02.11.2023.**

**Gjyqtarja,**  
**Halide Reka d.v.**